

[Albanian]

Sherbimet e gjuhës angleze për të rritur (ELSA)

English Language Services for Adults (ELSA)

Financuar nga
Ministry of Community,
Aboriginal & Women's Services

Settlement & Multiculturalism Branch

British Columbia Settlement and
Adaptation Program
(BCSAP)

1. Cfare eshte ELSA?

ELSA do te thote Sherbimet e Gjuhës Angleze për të Rritur. Programi ELSA është mesim e bazave të gjuhës angleze për të rritur të sapoardhur në Kanada, i cili financohet nga qeveria. Ky program është pa para për studentet. **Juve nuk paguheni për të vazhduar ELSA.**

2. Kush mund të vazhdojë ELSA?

Duhet të jesh i sapoardhur në Kanada, 17 vjeç a sipër, dhe me status permanent resident. Shtetasit Kanadezë dhe Kerkuesit për Status Refugjati **nuk mund** të regjistrohen tek ky program në zonën e Greater Vancouver (nga Horseshoe Bay në Langley) dhe në Krahinën e Greater Victoria Regional Districts. Por, ata mund të vazhdojnë klasat e ELSA po të jenë jashtë kësaj zone. Gjithashtu ju duhet që të keni të pakten **nje** nga dokumentat e mëposhtme:

- Numuri dhe Karta e Permanent Resident (PRC)
- Konfirmimi i Permanent Resident (Formulari numur IMM5292).
- Shenimi i Mberritjes (Formulari IMM100- I nxjerrë para datës Qershor 2002).
- Shenimi i Vizitorit (ceshtje TIPI 17)
- Leje Pune (Autorizim Pune) – ceshtje Tipi 17.
- Leje Studimi (Autorizim Studenti) – ceshtje TIPI 37.
- Leje Vendbanimi të Perkohshëm (Leje Ministeriale)-ceshtje TIPI 86,87,88 and 89.
- Njoftimi i Vendimit të Divizionit për Mbrojtjen e Refugjateve në Bordin e Immigranteve dhe Refugjateve (IRB) që verteton statusin si refugjatë konvente.
- Letter nga Shtetësia dhe Emigracioni i Kanadase (CIC) që aprovon qëndrimin në Kanada gjatë kohës që vazhdon procedura për kërkesën për banim të përhershëm (aprovim në parim).

3. A me duhet leje studimi?

Ata që nuk kanë Leje Banimi të Përhershëm (PRC), ose Shenim Mberritje (IMM1000), ose Leje Studimi (dokumentat që përshkruhen me lartë në a, c dhe f) duhet të aplikojnë për Leje Studimi në Shtetësi dhe Emigracioni i Kanadase (CIC). Pasi të keni mbaruar vlerësimin dhe rekomandimin, shko në shkollë për të marrë një vertetim regjistrimi, të cilin duhet me e paraqit të zyrës e CIC për të kërkuar leje studimi.

4. Cfare te bej per femijet e mij?

Disa klasa të ELSA kanë shërbim pa pagesë për kujdesje për fëmijet në moshe parashkollë. Mëqenese nuk ka shumë vende të lira, shpesh here do t'ju duhet që ti rregulloni vetë fëmijet.

5. Cilat jane shkallet e ELSA?

Pasi të paraqisni kerkese, do të caktoheni për një test vlerësimi të gjuhës Angleze (test). Zyra e Testimi do të përcatojë nivelin tuaj. Juve nuk mund të zgjidhni nivelin tuaj sipas dëshirës. Nivelet janë niveli baze dhe tre shkallë të nivelit fillestar.

6. Cfare do te mesoj ne klasen ELSA?

Anglishtja juaj do të jetë e afte që juve të flisni me mesuesit e shkollës, punonjësit e dyqaneve, doktorin, etj. Do të mesoni në lidhje me sistemin politik në Kanada, ligjet, mjekësinë dhe shumë gjëra të tjera. ELSA nuk është mesim për përgatitje për punë. Mund t'ju duhet që të mesoni Anglisht me shumë pasi të perundoni programin ELSA që të jeni të afte për punë. ELSA nuk ju paguan për këtë gjë.

7. Ku jane klasat ELSA?

Mbi 50 shkollë në Vancouver dhe në zonat fqinje, në Fraser Valley dhe në zonat e tjera të British Columbia ofrojnë klasat ELSA. Lista e shkollave gjendet në www.elsanet.org.

8. Ne cilen shkollë të shkoj?

Juve mund të zgjidhni shkollën tuaj. Mund të qelloj që nuk do të gjeni vend në shkollën me të afert pasi disa shkolla kanë lista pritje të gjata. Jo të gjitha shkollat kanë klase në nivelin tuaj ose në kohën kur ju dëshironi të shkoni.

9. Kur janë klasat e ELSA?

Mesimet janë në mëngjes, pasdite dhe në darkë. Klasat e plota janë 25 orë në javë. Klasat e tjera janë 9 deri në 15 orë në javë.

10. Kur fillojnë klasat e ELSA?

Mund të fillosh kur ka një vend në nivelin tend në klase. Shpesh herë do të futesh në një klasë në vazhdim në vendin e një studenti që ka ikur ose do të futesh në listen e pritjes.

11. Sa e gjatë është koha e pritjes?

Në disa shkolla juve mund të filloni direkt. Disa klasa mund të mos kenë vende kështu që do të ju duhet të prisni (zakonisht jo më shumë se 2 deri në 3 muaj).

12. Sa i gjatë është programi i ELSA?

Shkolla do t'ju thotë për sa kohë mund të vazhdoni në këtë program deri në një maksimum. Disa mesojnë Anglisht shumë shpejt. Ata që e fillojnë në nivelin fillestar mund të duhet një kohë më e gjatë. **Në rast se Anglishtja juaj është në permiresim**, juve mund të perfundoni nivelin 3 të ELSA.

13. A mund të vazhdoj të marr Employment Insurance (EI)?

Duhet që t'i thoni shkollës që jeni duke marrë EI. Paraqituni në qendrën me të afert tuajen të Human Resources për të pyetur nëse mund të vazhdoni të merrni të ardhura from EI, ndërsa vazhdoni shkollën. **Mos e lër punën për të vazhdosh mesimet tek ELSA.**

14. Cilat janë rregullat e ndjekjes së shkollës?

Shkolla do t'ju thotë rregullat e paraqitjes. **Juve duhet që të shkoni në mesim rregullisht ose largohuni.** Në rast se i fillon dhe i ndalon mesimet shpejt mund të mos ju lejojnë të vazhoni perseri. Në rast emergjence njoftoni shkollën për shqetësimin. Ata që marrin EI nuk marrin të ardhura kur mungojnë.

15. Kur mund të aplikoj në ELSA?

Aplikoni vetëm kur mund të shkoni në shkollë. Mos aplikoj kur ke plan për udhëtim, spital, ose ke femijë. Rezultatet e mesimit janë të vlefshme për 6 muaj. Po nuk filluat mesim brenda 6 muajve nga data e vlerësimit do t'ju duhet që të jepni test perseri.

16. C'fare ndodh pas aplikimit?

Do të merrni një leter me ditën dhe kohën dhe vendin për testin e vlerësimit. Kjo behet para se të shkosh në klasat tek ELSA.

17. A mund ta ndryshoj shkollën?

Ju mund të ndryshoni shkollën vetëm po të keni arsye të rëndësishme (për shembull në rast se leviz). Pyet në shkollë nëse mund të levizesh. Ata mund që të mos jeni dakort. Në rast se i fillon dhe i ndalon mesimet shpejt ata mund t'ju ndalojnë që të vazhdoni me tej.

18. Po në rast se nuk mund të shkoj në ELSA?

Ka shumë klasa të tjera Anglisht të shumë niveleve. Keshillat e shkollave, kolegjet, qendrat e komunitetit dhe agjensitë e emigracionit dhe shkollat private afrojnë klasa. To klasa mund të jeni me pagesë. Në seksionin "LINKS" të www.elsanet.org ka një listë të të gjitha kurseve ESL në British Columbia. Për programet jashtë ELSA ju duhet të aplikoni direkt në shkollën perkatese dhe jo në qendrën e vlerësimit të ELSA's.

19. Si aplikohet për ELSA?

Shkruaj, telefono, fakso në një nga këto zyra për të marrë një formular, kerkese. Për njerezit që jetojnë në Vancouver, North Vancouver, West Vancouver, Richmond, South Delta, Burnaby ose NewWestminster:

Western ESL Services
ELSA Assessment and Referral Centre
#208 – 2525 Commercial Drive
Vancouver, BC V5N 4C1
Tel (604) 876-5756
Fax (604) 876-0134

Për njerezit që jetojnë në Surrey, North Delta, Coquitlam, Port Coquitlam, Maple Ridge ose në Fraser Valley:

Surrey Language Assessment Centre
#202 – 7337 137th St.
Surrey, BC V3W 1A4
Tel (604) 507-4150
Fax (604) 507-4155

Njerezit që jetojnë në zonat e tjera mund të aplikojnë drejtpërdrejt në një shkollë në zonën e tyre ku ka ELSA.

Dergoni ose sillni një aplikim të plotësuar me një fotokopje të dokumentit tuaj të emigracionit sipas paragrafit 2 më lart (të dyja anet e kartës së banorit të perhershëm) me gjithë aplikim. Shkruaj të gjitha emrat në aplikim ashtu siç paraqiten në dokumentin tuaj.

Sillni me vete dokument origjinal, jo fotokopje në intervistën tuaj të vlerësimit si dhe në shkollë kur regjistrohesh.